

VENDIM
Nr.718, datë 3.9.2010

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, SI KONTRIBUT
PËR NDËRTIMIN E PARKUT KOMBËTAR SHQIPTAR “NËNË TEREZA”, NË
KLEVELAND-OHIO, SHBA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t’i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, si kontribut për ndërtimin e Parkut Kombëtar Shqiptar “Nënë Tereza”, në Kleveland-Ohio, SHBA.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
 3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha